



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER  
E KOSOVËS | OF COMMERCE

## *HULUMTIM RRETH ZBATIMIT TË LIGJIT TË PUNËS TEK SEKTORI PRIVAT*

---

Korrik, 2017

# PËRMBAJTJA

Informata mbi Hulumtimin.....	4
<b>I. Takimet nëpër Njësi Rajonale.....</b>	<b>5</b>
1. 1 Tryezë diskutimi në Regjionin e Prizrenit.....	5
1. 2 Tryezë diskutimi në Regjionin e Gjakovës.....	5
1. 3 Tryezë diskutimi në Regjionin e Gjilanit.....	6
1. 4 Tryezë diskutimi në Regjionin e Ferizajt .....	6
1. 5 Tryezë diskutimi në Regjionin e Pejës.....	6
1. 6 Tryezë diskutimi në Regjionin e Mitrovicës .....	7
<b>II. Përpunimi i të dhënave të dalura nga pyetësoret.....</b>	<b>8</b>
2. 1 A posedojnë të punësuarit Kontrata të punës.....	<b>8</b>
2. 2 A është duke u zbatuar Marreveshja e Pergjithshme Kolektive e Kosovës, dhe a mendoni që duhet të jetë obligative për të gjitha ndërmarrjet.....	9
2. 3 Në çfarë periudhe është e lidhur Kontrata e punës në afat të caktuar .....	9
2. 4 A e respektoni orarin e punës.....	10
2. 5 A kompensohet i punësuar për punën më të gjatë se orari i punës, punën në ditët e festave zyrtare si dhe për punën e natës.....	11
2. 6 A jeni duke e kompenzuar pushimin e lehonisë sipas Ligjit të punës.....	11
2.7 A keni pasur ndonjë shkeputje të kontratës se punës për të punësuarën, gjatë kohës së shtatzanisë dhe pushimit të lehonies .....	12
2. 8 A kompensohet pushimi i mjeksor.....	13
2. 9 A e percaktoni me marreveshje më të punësuarin orarin e shfrytëzimit të pushimit vjetor.....	13
2. 10 Deri në çfarë periudhe e aplikoni pushimin papagese .....	14
2. 11 A posedoni akt të brendshëm me të cilin i percaktoni të drejtat dhe detyrimet e palëve. ....	14
2. 12 A merret parasysh parimi i barazise gjinore dhe mosdiskriminimit në baza gjinore në kriteret dhe procedurat për punësim dhe përzgjedhje të stafit në kompaninë tuaj.....	15
2. 13 A kompenzohet përvoja e punës .....	15
2. 14 Sa mendoni që për cdo vit duhet të jetë rritja e përvojës së punës.....	16
2. 15 A e zbatoni punën provuese sipas Ligjit të punës.....	17
2. 16 A mendoni që puna e praktikantit duhet të konsiderohet si përvojë pune .....	17
2. 17 A keni të punësuar nën moshën 18 vjeqare në kompaninë tuaj.....	18
2. 18 A i numëroni si punë nate, orët e punës ndërmjet orës 22:00 dhe 06:00.....	18
2. 19 A jeni duke i zbatuar rregullat dhe procedurat e përgjithshme për mbrojtjen dhe sigurinë në punë, që janë të përcaktuara me Ligjin për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të	

të Punësuarve dhe Mbrojtjen e Ambientit të Punës .....	19
2. 20 A mendoni se Libreza e punës duhen të hiqet nga Ligji i Punës .....	19
2. 21 A mendoni se duhet të zgjatet mosha e pensionimit për një kategori të punësuarish.....	20
2. 22 A e respektoni pagën minimale .....	20
2. 23 A mendoni se paga minimale duhet të jetë e përshkallzuar sipas kategorive .....	21
2. 24 Sa mendoni që duhet të jetë paga minimale.....	21
2. 25 A e njoftoni paraprakisht të punësuarin për ndërprerjen e Kontrates së punës .....	22
2. 26 A keni pasur ndonjë rast që mosmarrëveshjet nga puna në mes të punësuarit dhe punesimit ti zgjidhin përmes ndërmjetesimit .....	22
2. 27 A janë të përballueshme gjobat e parapara në Ligjin e punës për kompaninë tuaj.....	23

### III. Përfundime dhe Rekomandime .....[24](#)

## INFORMATA MBI HULUMTIMIN

Ky hulumtim është bërë në rajone të ndryshme të vendit tonë, ku në kuadër të këtij hulumtimi janë anketuar rreth 500 kompani nga sektorë të ndryshëm, si sektori i tregtisë me pakicë, sektori i tregtisë me shumicë, sektori i ndërtimit, sektori i prodhimit si dhe sektori i shërbimeve. Hulumtimi është realizuar përmes një pyetësoi i cili ka përfshire 28 pyetje që kanë të bëjnë me Ligjin e punës, ku opsionet për përgjigje kanë qenë po/ jo/ nuk e di, dhe po ashtu u është kërkuar të japin rekomandimet e tyre në fusha të caktuara.

Për çdo kompani është bërë hulumtimi rreth zbatimit të legjislacionit të punës, kryesisht ngecjeve në implementimin e tij në praktikë.

Inciativa për këtë hulumtim rreth mosimplementimit të Ligjit të punës nga sektori privat ka qenë shumë e mirëseardhur nga çdo kompani, duke shprehur gadishmërin e tyre për bashkëpunimin në dhënien e rekomandimeve të tyre nga ana praktike. Ky hulumtim është kryer për herë të parë, me mbështetjen e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Soziale-MPMS.

Gjatë hulumtimit përveq që kemi anketuar 500 kompani, neve kemi mbajtur edhe takime nëpër Njesi Rajonale (Gjakovë, Prizren, Gjilan, Ferizaj, Peje dhe Mitrovicë) me biznese për t'u njoftuar me konkretisht rreth problemeve që ballafaqohen për cdo ditë rreth mosimplementimit të Ligjit të punës.

Një element çka është shumë i rëndësishëm është se pasi që Ligji i punës është në plotësim ndryshim, shumë kompani kanë shprehur gatishmëri që gjatë kësaj periudhe të japin kontributin e tyre nga përvojat e tyre praktike nëpërmjet dhënies së propozimeve të tyre, me çka edhe do të reflektojnë në nxitjen e investimeve të huaja dhe në rritjen e punësimit.

## TAKIMET NËPËR NJËSI RAJONALE

Edhe në kuadër të diskutimeve që i kemi zhvilluar nëpër Njësi Rajonale (Prizren, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Pejë dhe Mitrovicë) mund ta vlersojmë si shumë pozitive dhënien e kontributit të kompanive në këto takime. Të gjitha kompanitë kanë shprehur interesim bashkëpunimi në lidhje me dhënien e propozimeve të tyre në plotësim ndryshimin e Ligjit të punës, që nesër Ligji i miratuar të jetë sa me konkret dhe mos të ndikojë negativisht në të bërit biznes.

### TRYEZE DISKUTIMI NË REGJONIN E PRIZRENIT

Në këtë takim kane marrë pjesë rreth 15 kompani reputative, me numër të madh të punëtorëve dhe tatimpagues të rregullt. Në lidhje me dispozitat ligjore përveç atyre që i kemi cekur në pyëtesor, ata si brengë të madhe e kane paraqitur çështjen e aftësimin të të punësuarve jashtë vendit për ndonjë profil të caktuar. Për arsye se kur i punësuar i aftësuar kthehet në Kosovë nuk qendron tek e njejta kompani që e ka aftësuar, por e ndërron vendin e punës duke shkuar tek kompania tjetër ndoshta për 50 euro me shume. Pasi është paraqitur si problem i madhe mos rregullimi i kësaj fushe, atëhere përfaqësuesit e kompanive kanë kërkuar që ta inkorporojnë një dispozite të re ligjore në plotësim ndryshimin e Ligjit të punës që e rregullon këtë çështje. Edhe Kontrata e punës është diskutuar mjaftë pasi kompanitë janë të shqetësuara me faktin që edhe pse i lidhin kontratat e punës në afat të caktuar, i punësuar i paparalajmrim ia ndërprejnë punën kjo dukuri është duke ndodhur më të madhe sidomos tek sektori i prodhimit dhe i ndërtimtarisë. Kompanitë gjatë diskutimit kanë potencuar që në plotësim ndryshimin e Ligjit të punës të parashihen edhe masa ndëshkuese për këtë kategori të punësuarve që pa asnjë justifikim e ndërpresin maredhënien e punës. Po ashtu përveç këtyre çështjeve kanë diskutuar edhe probleme tjera që pengojnë në të bërit biznes, si pushimi mjeksor, pushimi i lehonisë, kontrata e punës, masat dicitlinore etj.

## **TRYEZE DISKUTIMI NË REGJONIN E GJAKOVËS**

Në Gjakovë kane marre pjesë rreth 15 kompani reputative, me numër të madh të punëtorëve dhe tatimpagues të rregullt. Edhe në këtë takim janë diskutuar problemet të cilat i hasin kompanite në lidhje me të punësuarit në moszbatimin e Ligjit të punës. Një ndër problemet më të mëdha janë masat disiplinore, ndërprerja e punës nga ana e të punësuarit pa paralajmrim, mos respektimi i orarit të punës, si dhe ikja e të punësuarit tek kompanit tjerat për 20 euro ma shume, ku sipas punëdhënësve këto dukuri e dëmtojnë shumë kompanin sidomos në vllugun e punës kur ajo vepron. Përfaqësuesit e kompanive gjatë diskutimit kanë potencuar që në plotësim ndryshimin e Ligjit të punës të parashihen edhe masa ndëshkuese për këtë kategori të të punësuarëve, pra kërkuan që masat diciplinore të specifikohen edhe për ata.

## **TRYEZE DISKUTIMI NË REGJONIN E GJILANIT**

Në Gjilan kanë qenë prezent rreth 10 kompani të cilat kanë dhënë kontributin e vet, duke paraqitur mangësit rreth dispozitave të Ligjit të punës, duke filluar nga pushimi i lehonisë, pushimi mjeksor, pushimi papagesë, masat disiplinore etj. Ata kanë theksuar se të punësuarit janë duke e keqpërdorur pushimin papagesë, ku kerkojne nga kompania një vertetim që punon në atë kompani dhe aplikojnë për vizë punë me ndonjë shtet të Evropës. Me këtë rast ata e shfrytëzojnë kompanin duke e marrë pushimin papagese më qellim se pas një viti do të kthehen prapë, por asnje punëtor më nuk e paraqet si obligim që t'i përgjigjet kompanisë, e kjo në fakt e dëmton shumë kompaninë. Gjithashtu si probleme tjera u paraqiten edhe masat disiplinore, ndërprerja e punës nga ana e të punësuarit pa paralajmrim, mos respektimi i orarit të punës, pushimi i lehonisë etj.

## **TRYEZE DISKUTIMI NË REGJONIN E FERIZAJIT**

Në Ferizaj kanë qenë prezent rreth 11 kompani të cilat kanë dhënë kontributin e vet, duke paraqitur mangësit rreth dispozitave të Ligjit të punës, duke filluar nga pushimi i

lehonisë, pushimi mjeksor, pushimi papagesë, masat disiplinore etj. Ata kanë theksuar se punëtorët janë duke e keqperdorur pushimin papagesë. Pastaj probleme tjera janë paraqitur edhe masat disiplinore, mos respektimi i orarit të punës, pushimi i lehonisë, mungesa e punëtove të profesionalizuar për lëmi të caktuara etj.

### **TRYEZE DISKUTIMI NË REGJONIN E PEJES**

Po ashtu edhe në Pejë kanë qenë prezent rreth 11 kompani të sektoreve të ndryshme. Përfaqësuesit e kompanive si shqetësim kryesor e kanë paraparë largimin e të punësuarëve, mandej mos respektimin e kontratës së punës, orarin e punës, masat disiplinore si dhe pushimin e lehonisë. Ata kanë potencuar se edhe pse e nënshkruajnë Kontraten në afat të caktuar prej gjashtë (6) muajve apo një (1) viti, të punësuarit paparalajmrim e braktisin punën, pa kurrfarë përgjegjësie dhe llogaridhenie ndaj punëdhënsit. Kjo paraqitet si një problem mjaftë i shprehur dhe i dëmshëm për kompaninë. Ata kerkuan që përveç dispozitave tjera në plotësim ndryshimin e Ligjit të punës të inkoorporohen edhe përgjegjësit e të punësuarit ndaj punëdhënsit, sidomos tek Kontrata e punës të specifikohet që i punësuarit duhet të jetë i obliguar që ta njoftoj se paku një (1) muaj me heret punëdhënsin për ndërprerjen e punës.

### **TRYEZE DISKUTIMI NË REGJONIN E MITROVICËS**

Në Mitrovicë kanë qenë prezent rreth 13 kompani të cilat kanë dhënë kontributin e vet duke paraqitur mangësit rreth dispozitave të Ligjit të punës, duke filluar nga mos profilizimi i punëtove, pastaj pushimi i lehonisë, pushimi mjeksor, pushimi papagesë si dhe masat disiplinore. Ata kanë theksuar se të punësuarit janë duke e keqperdorur pushimin papagesë. Gjithashtu potencuan se nuk e respektojnë Kontraten e punës të nënshkruar në afat të caktuar, pra e braktisin punën pa njoftimin e punëdhënsit. Sipas tyre duhet të inkoorporohen dispozita të reja që i konkretizojnë masat disiplinore ndaj të punësuarit.


## PËRPUNIMI I TË DHËNAVE TË DALURA NGA PYETËSORET

Gjatë, mbajtjes së takimeve nëpër Njesi Rajonale, neve i kemi diskutuar edhe të gjeturat në terren të cilat i kemi realizuar përmes pyetesoreve të realizuara në 500 kompani sektoresh të ndryshme. Të dhënat që kanë dalur nga pyetësoret janë përkrahur edhe nga diskutimet që janë mbajtur nëpër të gjitha rajonet e Kosovës. Tani në mënyrë të detajuar do të elaborojmë secilen pyetje të cilën e kemi paraparë në pyetësor:

### 1. A POSEDOJNË TË PUNËSUARIT KONTRATA TË PUNËS

Njëri ndër nenet i cili ka qenë mjaftë i diskutuar në Ligjin aktual të punës është Kontrata e punës, përmes këtij hulumtimi jemi munduar ta paraqesim një pasqyre reale tek antarësia jonë duke e analizuar kompanin e tyre se a kanë të punësuarit kontrata të punës. Prandaj, sipas hulumtimit të bërë nga të gjitha kompanitë kemi këtë rezultat:

- 1.1 **Po** kanë deklaruar 417 kompani ose 83.40 %
- 1.2 **Jo** kanë deklaruar 56 kompani ose 11.20 %
- 1.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 27 kompani ose 5.40 %






## 2. A ËSHTË DUKE U ZBATUAR MARREVESHJA E PËRGJITHSHME KOLEKTIVE E KOSOVËS, DHE A MENDONI QË DUHET TË JETË OBLIGATIVE PËR TË GJITHA NDËRMARRJET

Ka pasur shume dilema se a duhet të zbatohet Marreveshja e përgjithshme kolektive tek bizneset, sa i obligon kjo marreveshje bizneset si dhe sa prej tyre e zbatojne në praktike. Gjatë këtij hulumtimi nga kompanit të cilat i kemi anketuar kemi këte rezultat:

2.1 **Po** kanë deklaruar 250 kompani ose 50 %

2.2 **Jo** kanë deklaruar 160 kompani ose 32 %

2.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 90 kompani ose 18 %



## 3. NË ÇFARË PERIUDHE ËSHTË E LIDHUR KONTRATA E PUNËS NË AFAT TË ÇAKTUAR

Në Ligjin e punës neni 10 Kontrata e punës në afat të caktuar është njëra ndër çështjet më të diskutuara si nga ana e institucioneve qeveritare, bizneseve dhe sindikatave. Në Ligjin e punës është e parapare që Kontrata në afat të caktuar është deri në 10 vite, ndërsa gjatë përpunimit të anketave dhe diskutimeve që i kemi pasur me biznese në tryezat e organizuara nëpër Njesi Rajonale kemi këtë rezultat:


3.1 Në afat prej 6 muajve kanë deklaruar 241 kompani ose 48.20 %

3.2 Në afat prej 1 viti kanë deklaruar 208 kompani ose 41.60 %

3.3 Në afat prej 3 vite kanë deklaruar 51 kompani ose 10.20 %

3.4 Ne afat prej 6 vite kanë deklaruar 0 kompani ose 0%

3.5 Ne afat prej 10 vite kanë deklaruar 0 kompani ose 0%




#### 4. A E RESPEKTONI ORARIN E PUNËS

Në kuadër të Ligjit të punës nuk nuk ka si të mungon edhe orari i punës një nen mjaftë i diskutuar nga të gjithë akteret. Prandaj edhe për këtë nen kompanitë e anketuara kanë deklaruar që e respektojnë orarin e punës ku sipas hulumtimit kemi këtë rezultat:

4.1 **Po** kanë deklaruar 473 kompani ose 94.60 %

4.2 **Jo** kanë deklaruar 21 kompani ose 4.20 %


4.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 6 kompani ose 1.20 %



## 5. A KOMPENSOHET I PUNËSUARI PËR PUNËN MË TË GJATË SE ORARI I PUNËS, PUNËN NË DITËT E FESTAVE ZYRTARE SI DHE PËR PUNËN E NATËS

Punëdhensit kanë deklaruar që të punësuarit kompenzohen sipas Ligjit të punës për punën jashtë orarit të punës, gjatë ditëve të festave si dhe për punën e natës. Andaj gjatë hulumtimit të këtyre kompanive që kanë qenë target i projektit kemi këtë rezultat:

- 5.1 **Po** kanë deklaruar 419 kompani ose 83.80 %
- 5.2 **Jo** kanë deklaruar 65 kompani ose 13 %
- 5.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 16 kompani ose 3.20 %




## 6. A JENI DUKE E KOMPENZUAR PUSHIMIN E LEHONISË SIPAS LIGJIT TË PUNËS

Kompenzimi i pushimit të lehonisë është paraqitur si një barrë e madhe për bizneset, të cilët edhe përkunder kësaj kanë deklaruar që e kompenzojnë lehonën për gjashtë (6) muaj me 70% të pagës bazë siç është e paraparë me Ligjin e punës. Por gjatë anketimit dhe diskutimeve bizneset kanë kërkuar që kjo dispozite të ndryshohet dhe më e mira kishte me qenë që gjashtë (6) mujori i parë të paguhet nga Qeveria e Kosovës, tre (3) mujori i dytë nga bizneset me 50% të pagës mesatare në Kosovë, si dhe tre (3) mujori papagëse.

Kurse për ta parë se sa ia kompenzojnë lehonës pushimin e lehonise bizneset, kemi këtë rezultat:

- 6.1 **Po** kanë deklaruar 335 kompani ose 67 %
- 6.2 **Jo** kanë deklaruar 120 kompani ose 24 %
- 6.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 45 kompani ose 9 %




## 7. A KENI PASUR NDONJE SHKËPUTJE TË KONTRATËS SE PUNËS PËR TË PUNËSUAREN, GJATË KOHËS SË SHTATZANISË DHE PUSHIMIT TË LEHONIES

Shumica e bizneseve gjatë anketimit si dhe mbajtjes së tryezave të diskutimit nëpër Njësi Rajonale kanë potencuar se nuk ia shkëputin e Kontratën e punës lehonës, por në realitet e respektojnë Ligjin e punës duke ia ruajtur vendin e punës. Andaj sa i përket hulumtimit kemi këtë rezultat:

7.1 **Po** kanë deklaruar 85 kompani ose 17 %

7.2 **Jo** kanë deklaruar 343 kompani ose 68.60 %

7.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 72 kompani ose 14.40 %




## 8. A KOMPENSOHET PUSHIMI MJEKSOR

Në bazë të hulumtimit shumica e kompanive kanë potencuar se ia kompenzojnë pushimin mjeksor të punësuarit sipas Ligjit të punës. Andaj, sipas pohimeve të tyre kemi rezultat:

8.1 **Po** kanë deklaruar 342 kompani ose 68.40 %

8.2 **Jo** kanë deklaruar 129 kompani ose 25.80 %

8.3 **Nuk e di** kanë deklaruar kompani 29 ose 5.80 %




## 9. A E PERCAKTONI ME MARRËVESHJE MË TË PUNËSUARIN ORARIN E SHFRYTËZIMIT TË PUSHIMIT VJETOR

I punësuarit gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar. Këtë të drejtë të shfrytëzimit të pushimit vjetor e respektojnë bizneset dhe e bëjnë në marrëveshje me të punësuarin. Andaj për shfrytëzimin e pushimit vjetor kemi këtë rezultat:

9.1 **Po** kanë deklaruar 450 kompani ose 90 %

9.2 **Jo** kanë deklaruar 23 kompani ose 4.60 %


9.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 27 kompani ose 5.40 %



## 10. DERI NË CFARË PERIUDHE E APLIKONI PUSHIMIN PAPAGESE

Bizneset janë të disponimit që përkundër punëve dhe angazhimeve tu'a japin të drejten të punësuarëve në shfrytëzimin e pushimit papagesë ashtu siç është e paraparë me Ligjin e punës. Andaj sa realizohet kjo e drejtë nga ana e të punësuarve gjatë hulumtimit kemi këtë rezultat:

- 10.1 **Një (1) vit** janë deklaruar 470 kompani ose 94 %
- 10.2 **Dy (2) vite** janë deklaruar 26 kompani ose 5.20 %
- 10.3 **Tri (3) vite** janë deklaruar 4 kompani ose 0.80 %




■ Po ■ Jo ■ Nuk e di

## 11. A POSEDONI AKT TË BRENDSHËM ME TË CILIN I PËRCAKTONI TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Shumica e bizneseve posedojnë akt të brendshëm, me të cilin i përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet mes të punësuarit dhe të punëdhënsit. Sipas hulumtimit kemi këtë rezultat:

- 11.1 **Po** kanë deklaruar 372 kompani ose 74.40 %
- 11.2 **Jo** kanë deklaruar 85 kompani ose 17 %
- 11.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 43 kompani ose 8.60 %




■ Po ■ Jo ■ Nuk e di

## 12. A MERRET PARASYSH BARAZIA GJINORE DHE MOSDISKRIMINIMIT NË BAZA GJINORE NË KRITERET DHE PROCEDURAT PËR PUNËSIM DHE PËRZGJEDHJE TË STAFIT NË KOMPANINË TUAJ

Po merret parasysh barazia gjinore kanë theksuar shumica e bizneseve të anketuar, duke cilësuar se e respektojnë Ligjin për barazi gjinore. Sipas pohimit të tyre kemi një të arritur të kënaqshme në këtë hulumtim, ku rezultatet janë këto:

- 12.1 **Po** kanë deklaruar 394 kompani ose 78.80 %
- 12.2 **Jo** kanë deklaruar 81 kompani ose 16.20 %
- 12.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 25 kompani ose 5 %




■ Po ■ Jo ■ Nuk e di

## 13. A KOMPENZOHEP PËRVOJA E PUNËS

Në Marrëveshjen e përgjithshme Kolektive të Kosovës është paraparë kompensimi i përvojës së punës. Sipas hulumtimit dhe diskutimeve që i kemi pasur me bizneset ata kanë reflektuar që duhet të punësuarëve të iu kompenzohet përvoja e punës. Sipas pohimeve të tyre kemi këtë rezultat:

- 13.1 **Po** kanë deklaruar 330 kompani ose 66 %
- 13.2 **Jo** kanë deklaruar 52 kompani ose 10.40 %
- 13.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 118 kompani ose 23.60 %




■ Po ■ Jo ■ Nuk e di

#### 14. SA MENDONI QË PËR ÇDO VIT DUHET TË JETË RITJA E PËRVOJËS SË PUNËS

Pasi bizneset kanë pohuar që duhet të kompenzohet përvoja e punës, ata kanë cekur edhe lartësin e shumës vjetorë që duhet të ju kompenzohet të punësuarëve për çdo vit. Sipas hulumtimit tonë e kemi këtë rezultat:

- 14.1 **0.3%** për çdo vit kanë deklaruar 154 kompani ose 30.8%
- 14.2 **0.5%** për çdo vit kanë deklaruar 243 kompani ose 48.60%
- 14.3 **0.7%** për çdo vit kanë deklaruar 103 kompani ose 20.60%




■ Po ■ Jo ■ Nuk e di

#### 15. SA I ZBATONI SHPËRBLIMET JUBILARE TË PARAPARA NË MARRVESHJEN E PËRGJITHSHME KOLEKTIVE TË KOSOVËS

Për shpërblimet jubilarë të parapara në Marrëveshjen e përgjithshme Kolektive të Kosovës, shumica e bizneseve kanë theksuar që nuk i kompenzojnë. Andaj sipas hulumtimit tonë e kemi këtë rezultat:

- 15.1 **Po** kanë deklaruar 141 kompani ose 28.20 %
- 15.2 **Jo** kanë deklaruar 178 kompani ose 35.60 %
- 15.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 181 kompani ose 36.20 %




■ Po ■ Jo ■ Nuk e di



## 16. A E ZBATONI PUNËN PROVUESE SIPAS LIGJIT TË PUNËS

Puna provuese përcaktohet me Kontratën e Punës. Për punën provuese sipas hulumtimit kemi këtë rezultat:

- 16.1 **Po** kanë deklaruar 395 kompani ose 79%
- 16.2 **Jo** kanë deklaruar 55 kompani ose 11%
- 16.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 50 kompani ose 10%




■ Po ■ Jo ■ Nuk e di

## 17. A MENDONI QË PUNA E PRAKTIKANTIT DUHET TË KONSIDEROHET SI PËRVOJË PUNE

Sipas hulumtimit tonë bizneset e kanë konsideruar që puna e praktikantit duhet të konsiderohet si përvojë pune. Andaj edhe rezultatet e hulumtimit e paraqesin pohimin e tyre:

- 17.1 **Po** kanë deklaruar 350 kompani ose 70 %
- 17.2 **Jo** kanë deklaruar 95 kompani ose 19 %
- 17.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 55 kompani ose 11%




■ Po ■ Jo ■ Nuk e di

## 18. A KENI TË PUNËSUAR NËN MOSHËN 18 VJEQARE NË KOMPANIN TUAJ

Bizneset kanë theksuar se nuk kanë të punësuar nën moshën 18 vjeqare në punë të rregullt, por disa prej tyre kanë deklaruar që në sezonin e verës i angazhojnë fëmijet e tyre sidomos në vjeljen e frutave apo mbjelljen e luleve me qëllim të përfitimit të shprehisë së punës. Andaj rezultati nga hulumtimi i bizneseve është:

- 18.1 **Po** kanë deklaruar 30 kompani ose 6 %
- 18.2 **Jo** kanë deklaruar 443 kompani ose 88.60 %
- 18.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 27 kompani ose 5.40 %




■ Po ■ Jo ■ Nuk e di

## 19. A I NUMËRONI SI PUNË NATE, ORËT E PUNËS NDËRMJET ORES 22:00 DHE 06:00

Sipas Ligji të punës edhe bizneset i numrojnë si punë nate orët mes 22:00 dhe 06:00. Andaj sipas hulumtimit kemi këtë rezultat:

- 19.1 **Po** kanë deklaruar 353 kompani ose 70.60 %
- 19.2 **Jo** kanë deklaruar 99 kompani ose 19.80 %
- 19.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 48 kompani ose 9.60 %




■ Po ■ Jo ■ Nuk e di

## 20. A JENI DUKE I ZBATUAR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN DHE SIGURINË NË PUNË, QË JANË TË PËRCAKTUARA ME LIGJIN PËR SIGURI NË PUNË, MBROJTJE TË SHËNDETIT TË TË PUNËSUARVE DHE MBROJTJEN E AMBIENTIT TË PUNËS

Bizneset e anketuara kanë pohuar se e respektojnë Ligjin për mbrojtje dhe siguri në punën, andaj sipas tyre kemi këtë rezultat:


- 20.1 **Po** kanë deklaruar 425 kompani ose 85 %
- 20.2 **Jo** kanë deklaruar 43 kompani ose 8.60 %
- 20.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 32 kompani ose 6.40 %



## 21. A MENDONI SE LIBREZA E PUNËS DUHEN TË HIQET NGA LIGJI I PUNËS

Për Librezen e punës shumica e bizneseve kanë pohuar që duhet të hiqet nga Ligji i punës. Prandaj rezultati i hulumtimit është ky:

- 21.1 **Po** kanë deklaruar 221 kompani ose 44.20 %
- 21.2 **Jo** kanë deklaruar 165 kompani ose 33 %
- 21.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 114 kompani ose 22.80 %




## 22. A MENDONI SE DUHET TË ZGJATET MOSHA E PENSIONIMIT PËR NJË KATEGORI TË PUNËSUARISH

Bizneset kanë pohuar që për një kategori të punësuarish mund të rritet mosha e pensionimit, sipas tyre kemi këtë rezultat:

22.1 **Po** kanë deklaruar 102 kompani ose 20.40 %

22.2 **Jo** kanë deklaruar 352 kompani ose 70.40 %

22.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 46 kompani ose 9.20 %



■ Po ■ Jo ■ Nuk e di


## 23. A E RESPEKTONI PAGEN MINIMALE

Për Pagën minimale kanë deklaruar shumica e bizneseve që e respektojnë. Sipas tyre kemi këtë rezultat:

23.1 **Po** kanë deklaruar 428 kompani ose 85.60 %

23.2 **Jo** kanë deklaruar 42 kompani ose 8.40 %

23.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 30 kompani ose 6%




■ Po ■ Jo ■ Nuk e di

## 24. A MENDONI SE PAGA MINIMALE DUHET TË JETË E PËRSHKALLZUAR SIPAS KATEGORIVE

Për arsye se paraqet diskriminim në moshë bizneset kanë potencuar që duhet të hjeket kategorizimi i Pagës minimale. Sipas të dhënave kemi këtë rezultat:

- 24.1 **Po** kanë deklaruar 51 kompani ose 10.2%
- 24.2 **Jo** kanë deklaruar 400 kompani ose 80%
- 24.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 49 kompani ose 9.8%




■ Po ■ Jo ■ Nuk e di

## 25. SA MENDONI QË DUHET TË JETË PAGA MINIMALE

Pasi paraqet një të drejtë themelore realizimi i Pagës minimale, bizneset kanë potencuar që duhet të rritet edhe lartësia e saj, ku sipas hulumtimit kemi këtë rezultat:

- 25.1 **170 euro** kanë deklaruar 65 kompani ose 13%
- 25.2 **190 euro** kanë deklaruar 150 kompani ose 30%
- 25.3 **220 euro** kanë deklaruar 285 kompani ose 57%




■ Po ■ Jo ■ Nuk e di

33.

## 26. A E NJOFTONI PARAPRAKISHT TË PUNËSUARIN PËR NDËRPRERJEN E KONTRATES SË PUNËS

Në momentin kur i punësuar nuk i përmbush kushtet e parapara me Kontratën e punës, punëdhësi ia shkëput Kontratën e punës duke e njoftuar paraprakisht një (1) muaj përpara ashtu siç është e paraparë me Ligjin e punës. Andaj sipas pohimeve të tyre kemi këtë rezultat:


- 26.1 **Po** kanë deklaruar 443 kompani ose 88.60 %
- 26.2 **Jo** kanë deklaruar 38 kompani ose 7.60 %
- 26.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 19 kompani ose 3.80 %



## 27. A KENI PASUR NDONJË RAST QË MOSMARRËVESHJET NGA PUNA NË MES TË PUNËSUARIT DHE PUNËDHËNËSIT TI ZGJIDHIN PËRMES NDËRMJETËSIMIT

Edhe pse është një rrugë mjaftë fasilituese për zgjidhjen e kontesteve nëpërmjet ndërmjetsimit, akoma bizneset nuk janë duke e realizuar këtë formë, ku sipas rezultateve të hulumtimit kemi këtë rezultat:

- 27.1 **Po** kanë deklaruar 109 kompani ose 21.80 %
- 27.2 **Jo** kanë deklaruar 298 kompani ose 59.60 %
- 27.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 93 kompani ose 18.60 %




## 28. A JANË TË PËRBALLUESHME GJOBAT E PARAPARA NË LIGJIN E PUNËS PËR KOMPANINË TUAJ

Bizneset në lidhje me gjobat e parapara në Ligjin e punës shumica prej tyre kanë potencuar që nuk janë të përballueshme. Andaj sipas hulumtimit kemi këtë rezultat:

28.1 **Po** kanë deklaruar 181 kompani ose 36.20 %

28.2 **Jo** kanë deklaruar 220 kompani ose 44 %

28.3 **Nuk e di** kanë deklaruar 99 kompani ose 19.80 %



## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Gjatë këtij hulumtimi, komuniteti i biznesit në Kosovë edhe njëherë potencoi se duhet të ndryshohet Ligji i punës, për arsye të disa neneve që krijojnë kosto në njëren anë dhe për inkooporimin e disa nene të reja që mbulojnë fushat specifike, e të cilat në fakt nuk janë në ligjin aktual në anën tjetër.

*Kontrata e punës*, paraqitet si njëra ndër problemet kryesore që nuk realizohet nga ana e të punësuarit edhe pse nënshkruhet me vullnet nga ana e dy palëve. Si problem enorm që është paraqitur në shumë raste atëherë kërkohet që në plotësim ndryshimin e ligjit të ri të punës të inkorporohen dispozita të reja ligjore që e obligojnë të punësuarin që brenda afatit prej tridhjetë (30) dite ta njoftoi punëdhënsin që dëshiron me e shkëputë marrëdhënien e punës. Ky është një satisfaksion shumë i mirë për punëdhënsin sepse ai brenda kësaj periudhe mundet me e gjetur ndonjë punëtor tjetër, pra në këtë mynyrë nuk e pengon apo nuk e ndalon në procesin e punës. Ndërsa sa i përket Kontratës në afat të caktuar shumica e biznese të anketuar kanë deklaruar që kontratat e punës i kanë të lidhura në afat prej gjashtë (6) muajsh deri në një vit. Çka do të thotë që akoma ka dilema që bizneset Kontratën në afat të caktuar ti paraqesi deri në tre (3) vjet e mandej kjo kontrate të llogaritet s'i kontrate në afat të pacaktuar (e përhershme). Dilema ishte se të punësuarit nuk i respektojnë Kontratën deri në një (1) vit, e mos të flasim për kontratat që bëhen në afat të pacaktuar.

*Pushimi i lehonisë*, gjatë tryezave të mbajtura nëpër regjione kemi pasur shumë diskutime në lidhje me pagesën apo kompenzimin e pushimit të lehonisë. Sa i përket kompenzimit të pushimit të lehonisë bizneset kanë propozuar që gjashtë (6) mujori i parë prej 70% të pagesë bazë të lehonës të kompenzohet nga Qeveria e Kosovës, kurse tremujori (3) i dytë prej 50% të pagesë mesatare të lehonës të kompenzohet nga bizneset dhe tre (3) mujori i tretë papagese.

Si brengë kryesore është paraqitur edhe kthimi në punë i të punësuarës pasi e ka mbaruar pushimin e lehonisë. Ata deklaruan se në të shumtën e rasteve edhe pse ia kompenzojnë pushimin e lehonisë të punësuarës për gjashtë (6) muaj me 70% të pagesë bazë dhe shfrytëzimit edhe të tre (3) muajve tjerë të përcaktuar më ligj, e punësuarat nuk kthehet në punë. Kjo është theksuar si problem nga ana e bizneseve pasi që paraprakisht asnjëherë lehonat e punësuarat nuk e kanë njoftuar punëdhënsin se do ta ndërpres marrëdhënien e punës, e në momentin e fundit pas një viti kur i realizon të gjitha të drejtat dhe i ruhet vendi i punës, ajo e njofton punëdhënsin që nuk do të kthehet më në punë. Kjo është një sfidë e madhe sepse e dëmton biznesin pasi ai ka shpresuar se do të kthehet e punësuarat në punë, andaj bizneset propozojnë që në plotësim ndryshim e ligjit të inkorporohet një dispozitë që e obligon lehonën që ta njoftoi paraprakisht punëdhënsin që mbas muajit të gjashtë a do të kthehet në punë apo jo.

*Pushimi papagese*, shumë biznese janë të indinjuar me të punësuarit që ua japin pushimin papagese në afat prej një (1) viti dhe bashke me pushimin ia lëshojnë edhe



një vertetim që punon në atë kompani. E mandej i punësuarit e shfrytëzon rastin duke aplikuar për vize pune me ndonjë shtet të Evropës ku punësohet e nuk kthehet më, pra nuk mbanë asnjë përgjegjësi ndaj punëdhënsit. Duke e parë si problem këtë dispozitë ligjore, kompanitë kanë kërkuar që nese të punësuarit i mundësohet realizimi i kësaj të drejte mos ta keqperdor, por brenda afatit ligjor të kthehte tek punëdhënësi që i'a ka mundësuar realizimin e pushimit papagesë, pra propozojnë që kjo çështje duhet të rregullohet me nje dispozite të re ligjore, duke ia specifikuar edhe përgjegjësit e të punësuarit ndaj punëdhënsit.

*Paga minimale*, kategorizimi i pagës minimale në dy grupe (deri në moshën 35 vjeç 130 euro dhe mbi 35 vjeç 170 euro) edhe nga ana e bizneseve është konsideruar si diskriminim i moshës, pasi edhe kështu paga minimale në Kosovë konsiderohet si paga më e vogël në Rajon dhe Evropë në vlerë prej 170 euro. Sipas hulumtimit të bizneseve dhe diskutimeve të shumta që i kemi pasur në terren mbi 80% e bizneseve kanë potencuar që duhet të hjeket kategorizimi i Pagës minimale. Po ashtu në lidhje edhe me rritjen e Pages minimale mbi 57% e bizneseve kanë deklaruar që duhet të rritet Paga minimale deri në 220 euro. Andaj sipas këtij hulumtimi Paga minimale duhet të implementohet nga secili punëdhënës, pasi që ka për qëllim garantimin e një niveli të ardhurash që siguron kushte bazike për jetesë. Megjithatë, nëse kjo nuk aplikohet në realitet, atëherë çfardo rritje e Pagës minimale nuk do të ketë ndikim në mirëqenien e të punësuarëve.

Sa i përket kompenzimit të përvojës së punës shumica e bizneseve janë deklaruar që e bëjnë këtë kompenzim në vlerë prej 0.5% në baza vjetore.

Aftësimi apo shkollimi të të punësuarve jashtë vendit për ndonjë profil të caktuar, gjatë diskutimeve që i kemi pasur nwpwr njesi rajonale wshtw paraqitur si problem i madhe nga ana e bizneseve. Arsye e shqetësimit wshtw se kur i punësuarit i aftësuar apo i shkolluar kthehet në Kosovë nuk qendron tek e njejta kompani që e ka aftësuar, por e ndërron vendin e punës duke shkuar tek kompania tjetër ndoshta për 50 euro me shume. Mos specifikimi apo mos rregullimi i kwsaj fushe është paraqitur si problem i madhe, atëhere përfaqësuesit e kompanive kanë kërkuar që ta inkorporojnë një dispozite të re ligjore në plotësim ndryshimin e Ligjit të punës që e rregullon këtë çështje.

Nga e tëra kjo duhet të theksojmë se të gjitha bizneset e anketuara janë për zbatimin e Ligjit të punës në tërësi si akt themelor në krijimin e marrëdhënies së punës, më qëllim të ikjesë së informalitet dhe mbrojtjes së konkurrencës lojale.

Për herë të parë OEK-u ka bërë kwtw hulumtim të detajuar rreth zbatimit të Ligjit të punës tek sektori privat, duke i konkretizuar nenet e caktuar që ndikojnë negativisht në të bërit biznes.

Natyrisht se në këtë rast Qeveria e Kosovës duhet të bëjë më shumë, së pari duhet t'i marr parasysh propozimet e biznesve që ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e raporteve kontraktuale mes punëdhënsit dhe të punësuarit. Këto çështje janë paraqitur shumë më heret si faktor pengues në të bërit biznese, por OEK-u nuk kishte

nxjerrë një studim të tillë. Për më tepër, Qeveria duhet të marrë për bazë rekomandimet, si dhe të rrit numrin e Inspektoreve të punës për mbrojtjen e konkurrencës si dhe të bëjë përpjekje për të nxitur ndërmarrjet informale të bëhen formale.

Ky hulumtim ka nxjerrë në pah nenet e caktuara të cilat duhet të ndryshohen si dhe inkorporimin e neneve të reja që nuk kanë qenë më herët dhe kanë paraqitur zbrastirë ligjore. Andaj OEK-u dhe anëtarët e saj mendojnë se sa më heret që bëhet plotësim ndryshimi i Ligjit të punës, aq më shpejtë do të përmirësohet ambienti i të bërit biznes, pra do të rregullohen në mënyren më të mirë raportet kontraktuale në mes të punëdhënsit dhe të punësuarit.

Oda Ekonomike e Kosovës, si gjithmon është në dispozicion të jap rekomandime, propozime dhe sugjerime profesionale për plotësim ndryshimin e Ligjit të punës të argumentuara nga ana praktike e që ndikojnë pozitivisht në krijimin e një ambienti më të mirë biznesor.